


DORACAK PRAKTIK PËR UMRE

(Sipas medh-hebit Hanefi)

Botim i rishikuar dhe i plotësuar

Fatmir SHABANI

Ermize SHABANI



Qendra Islamike Kulturore Shqiptare në Norvegji

Oslo, 2026

PARATHËNIE

- Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.
- Paqja dhe mëshira qofshin mbi të Dërguarin e Allahut Muhammedin ﷺ, familjen e tij dhe shokët e tij.
- Ky doracak është përgatitur për umrexhinjtë dhe për udhëheqësit e grupeve, me qëllim që Umra të kryhet saktë, qartë dhe sipas rregullave të medh-hebit Hanefi, duke shmangur gabimet e shpeshta dhe duke mos u ngarkuar me gjëra që nuk janë obligim.
- Qëllimi i këtij doracaku është t'i ndihmojë umrexhinjtë ta kryejnë Umren me qetësi shpirtërore, dituri dhe sinqeritet, duke u përqëndruar në thelbin e adhurimit.

V L E R A E U M R E S

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: الْعُمْرَةُ إِلَى الْعُمْرَةِ كَفَّارَةٌ لِمَا بَيْنَهُمَا، وَالْحَجُّ الْمَبْرُورُ لَيْسَ لَهُ جَزَاءٌ إِلَّا الْجَنَّةُ

رواه البخاري ومسلم

“Umra deri në Umre shlyen mëkatet mes tyre, ndërsa Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit.”

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Umra është një adhurim i madh që e pastron zemrën, e forcon lidhjen me Allahun dhe i fal umrexhiut mundësinë për t’u kthyer tek Allahu me pendim dhe sinqeritet.

Kryerja e Umres kërkon:

- nijet të pastër,
- durim gjatë sprovave,
- respekt ndaj rregullave fetare,
- etikë ndaj muslimanëve të tjerë
- mos humbje e kohës së lirë, sepse mund të jetë umra e fundit për ty.

Umra nuk është vetëm veprim trupor, por
adhurim i zemrës dhe i shpirtit.

SHTYLLAT DHE OBLIGIMET E UMRES

Umra përbëhet nga këto shtylla dhe obligime:

1. Ihrami me nijet dhe telbije
2. Tavafi rreth Qabes
3. Sa'ji mes Safasë dhe Merves
4. Qethja ose rruatja e flokëve

Pa kryerjen e këtyre veprimeve, Umra nuk plotësohet.

Është shumë e rëndësishme që umrexhiu të dallojë mes:

- farzit,
- vaxhibit,
- sunetit,
- dhe veprimeve të pëlqyera,

Në mënyrë që të mos e ngarkojë veten me gjëra që nuk janë obligim dhe të mos e komplikojë adhurimin.

IHRAMI DHE NIJETI

Ihrami është hyrja në një gjendje të veçantë adhurimi, me të cilën umrexhiu i ndalon vetes disa veprime të lejuara në jetën e përditshme, me qëllim kryerjen e Umres.

Ihrami përbëhet nga:

- nijeti,
- dhe telbija.

Pa njëriën prej këtyre dyjave, Ihrami nuk është i vlefshëm.

MIKATI

Mikati është vendi ku bëhet nijeti për Umre dhe ku umrexhiu hyn në Ihram.

Nuk lejohet kalimi i mikatit pa Ihram për atë që ka nijet të kryejë Umren.

Ihrami mund të vishet edhe më herët, ndërsa nijeti bëhet në mikat.

PËRGATITJA PARA IHRAMIT

Para veshjes së Ihramit, është e pëlqyer:

- prerja e thonjve,
- pastrimi i trupit,
- larja (gusul ose larje e zakonshme),

Nëse këto nuk bëhen, nuk prish punë, Umra mbetet e vlefshme.

VEHJJA E IHRAMIT

Për meshkuj:

Ihrami përbëhet nga dy copa të bardha,
pa qepje:

- njëra për pjesën e poshtme,
- tjetra për pjesën e sipërme.

Për gratë:

- Nuk kanë veshje të veçantë Ihrami.
- Ato veshin rrobat e zakonshme islame,
duke lënë fytyrën dhe duart të zbuluara.

NIJETI I UMRES

اللَّهُمَّ إِنِّي نَوَيْتُ الْعُمْرَةَ فَأَحْرَمْتُ بِهَا لِلَّهِ تَعَالَى، فَيَسِّرْهَا لِي
وَتَقَبَّلْهَا مِنِّي

All-llahumme innī nevejtu-l-‘umrete fe ehremtu
bihā lil-lāhi te‘ālā, fe jessirhā lī ve tekabbelhā
minnī.

O Allah, vendosa ta kryej Umren dhe për hir
Tënde hyra në Ihram. Ma lehtëso dhe ma prano.

TELBIJA

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ وَالنِّعْمَةَ لَكَ
وَالْمُلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ

Lebbejke All-llahumme lebbejke,
lebbejke lā sherīke leke lebbejke,
innel-hamde ven-ni‘mete leke vel-mulk,
lā sherīke lek.

Meshkujt e thonë me zë të lartë, gratë me zë të
ulët.

NDALIMET NË IHRAM

Pas hyrjes në Ihram, umrexhiu ndalon vetes

disa veprime të caktuara:

- prerja e thonjve,
- prerja e flokëve dhe qimeve,
- parfumosja e trupit apo rrobave,
- marrëdhëniet intime,
- fejesa dhe martesë,
- gjuetia.

Për meshkuj ndalohet:

- mbulimi i kokës,
- veshja e rrobave të qepura.

Për gratë ndalohet:

- mbulimi i fytyrës,
- përdorimi i dorezave.

ÇFARË LEJOHET NË IHRAM

Gjatë Ihramit lejohet:

- larja e trupit,
- ndërrimi i Ihramit nëse ndotet,
- përdorimi i rripit,
- mbajtja e orës, kufjeve dhe syzeve,
- përdorimi i sandaleve,
- qëndrimi nën hije apo çadër.

Këto veprime nuk e dëmtojnë Ihramin dhe janë të lejuara.

TAVAFI I UMRES

Tavafi është rrotullimi rreth Qabes shtatë herë, duke e pasur Qaben në anën e majtë.

Tavafi është FARZ i Umres. Pa Tavaf, Umra nuk është e vlefshme.

KUSHTET E TAVAFIT

Që Tavafi të jetë i vlefshëm, duhet:

- të jetë me abdes,
- të kryhen 7 rrotullime të plota,
- Qabeja të jetë në anën e majtë,
- Tavafi të bëhet jashtë mekemit Ismail
- të kryhet brenda Mesxhidul-Haramit.

Nëse mungon ndonjë nga këto kushte,

Tavafi nuk është i vlefshëm.

NIJETI I TAVAFIT

اللَّهُمَّ إِنِّي أُرِيدُ طَوَافَ بَيْتِكَ الْحَرَامِ، فَيَسِّرْهُ لِي وَتَقَبَّلْهُ مِنِّي

Allāhumme innī urīdu ʔavāfa bejtikel-ḥarām, fe jessirhu lī ve teqābbelhu minnī.

O Allah, unë kam për qëllim ta kryej tavafin rreth Shtëpisë Tënde të Shenjtë, ma lehtëso dhe ma prano prej meje.

FILLIMI I TAVAFIT

Tavafi fillon nga Guri i Zi.

Nëse mundet:

- E puth Gurin e Zi (gjë që është e pamundur).

Nëse nuk mundet:

- E bën shenjë me dorën e djathtë dhe thotë: Bismil-lah All-llahu ekber

بِسْمِ اللَّهِ، اللَّهُ أَكْبَرُ

RROTULLIMET E TAVAFIT

Tavafi përbëhet nga 7 rrotullime.

Çdo rrotullim:

- fillon te Guri i Zi,
- përfundon te Guri i Zi.

Qabeja duhet të jetë gjithmonë në anën e majtë.

IDTIBA' DHE REMEL (VETËM PËR MESHKUJ)

Idtiba është zbulimi i supit të djathtë duke vendosur rrobën e Ihramit nën sqetullën e djathtë dhe mbi supin e majtë.

Remel është ecja pak më e shpejtë me hapa të shkurtër (nëse të mundësohet).

DUA-LUTJE GJATË TAVAFIT

Nuk ka dua-lutje të detyruar ose të veçant për çdo rrotullim të Tavafit.

Umrexhiu mund të:

- lexojë Kur'an,
- bëjë dhikr,
- ose të lutet me fjalët e veta.
-

1. Gjatë rrotullimit të parë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ وَلَا حَوْلَ وَلَا
قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ
اللَّهُمَّ إِيْمَانًا بِكَ وَتَصَدِيقًا بِكِتَابِكَ وَوَفَاءً بِعَهْدِكَ وَاتِّبَاعًا لِسُنَّةِ
نَبِيِّكَ مُحَمَّدٍ ﷺ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ الدَّائِمَةَ فِي الدِّينِ
وَالدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَالْفَوْزَ بِالْجَنَّةِ وَالنَّجَاةَ مِنَ النَّارِ

Subhanallah! Falënderimi i takon Allahut. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Allahu është më i Madhi. Nuk ka fuqi përveç fuqisë së Allahut të Lartësuar. Paqja dhe mëshira qofshin mbi të Dërguarin e Allahut ﷺ. O Allah, po të besoj Ty, po e vërtetoj Librin Tënd, po e përmbush besën ndaj Teje dhe po ndjek Sunetin e Profetit Tënd Muhamed ﷺ. O Allah, kërkoj prej Teje falje dhe shëndet të përhershëm në fe, në këtë botë dhe në ahiret, fitimin e xhenetit dhe shpëtimin nga zjarri.

2. Gjatë rrotullimit të dytë:

اللَّهُمَّ إِنَّ هَذَا الْبَيْتَ بَيْتُكَ وَالْحَرَمَ حَرَمُكَ وَالْأَمْنَ أَمْنُكَ وَالْعَبْدَ
عَبْدُكَ وَإِبْنَ عَبْدِكَ وَإِبْنَ أُمَّتِكَ فَحَرِّمْ لِحُومَنَا وَدِمَاءَنَا عَلَى النَّارِ
اللَّهُمَّ حَبِّبْ إِلَيْنَا الْإِيمَانَ وَرَئِيهٖ فِي قُلُوبِنَا وَكَرِّهْ إِلَيْنَا الْكُفْرَ
وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ وَاجْعَلْنَا مِنَ الرَّاشِدِينَ

O Allah, kjo shtëpi është Shtëpia Jote, ky harem është haremi Yt, siguria është në dorën Tënde.

Unë jam robi Yt dhe biri i robit Tënd.

Na ruaj nga zjarri. O Allah, na e bëj të dashur imanin dhe zbukuroje atë në zemrat tona. Na bëj që ta urrejmë kufirin, fiskun dhe mosbindjen dhe na bëj prej të udhëzuarve.

3. Gjatë rrotullimit të tretë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الشِّرْكِ وَالشَّكِّ وَالنَّفَاقِ وَسُوءِ الْأَخْلَاقِ
وَسُوءِ الْمَنْظَرِ وَالْمُنْقَلَبِ فِي الْمَالِ وَالْأَهْلِ وَالْوَلَدِ، اللَّهُمَّ إِنِّي
أَسْأَلُكَ رِضَاكَ وَالْجَنَّةَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ سَخَطِكَ وَالنَّارِ، اللَّهُمَّ إِنِّي
أَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْقَبْرِ وَفِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ

O Allah, kërkoj mbrojtje prej Teje nga shirku, dyshimi, hipokrizia, morali i keq, pamja e keqe dhe përfundimi i keq në pasuri, familje dhe fëmijë. O Allah, kërkoj kënaqësinë Tënde dhe

xhenetin dhe kërkoj mbrojtje nga zemërimi Yt dhe zjarri. O Allah, kërkoj mbrojtje prej Teje nga sprova e varrit dhe sprova e jetës dhe vdekjes.

4. Gjatë rrotullimit të katërt:

اللَّهُمَّ اجْعَلْ عُمْرَتِي مَبْرُورَةً وَسَعْيِي مَشْكُورًا وَذَنْبِي مَغْفُورًا
وَعَمَلِي مَقْبُولًا وَتِجَارَتِي لَنْ تَبُورَ، يَا عَالَمَ مَا فِي الصُّدُورِ،
أَخْرِجْنِي يَا اللَّهُ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ
مُوجِبَاتِ رَحْمَتِكَ وَعَزَائِمِ مَغْفِرَتِكَ وَالسَّلَامَةَ مِنْ كُلِّ إِثْمٍ وَالْعَنِيمَةَ
مِنْ كُلِّ بَرٍّ وَالْفَوْزَ بِالْجَنَّةِ وَالنَّجَاةَ مِنَ النَّارِ

O Allah, bëje umren time të pranuar, sa'jin tim të shpërblyer, gjynahet e mia të falura dhe veprat e mia të pranuar, dhe tregtinë time pa humbje. O Ti që di çfarë fshihet në gjokse, më nxirr nga errësirat në dritë. Kërkoj prej Teje shkaqet e mëshirës Sate, faljen e plotë, shpëtimin nga çdo mëkat, fitimin e çdo të mire, xhenetin dhe shpëtimin nga zjarri.

5. Gjatë rrotullimit të pestë:

اللَّهُمَّ أَظْلَنِي تَحْتَ ظِلِّ عَرْشِكَ يَوْمَ لَا ظِلَّ إِلَّا ظِلُّكَ، وَاسْقِنِي مِنْ حَوْضِ نَبِيِّكَ مُحَمَّدٍ ﷺ شَرْبَةً هَنِينَةً مَرِينَةً لَا أَظْمَأُ بَعْدَهَا أَبَدًا، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ ﷺ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا اسْتَعَاذَكَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ ﷺ

O Allah, më fut nën hijen e Arshit Tënd atë ditë kur nuk ka hije tjetër përveç hijes Sate.

Më mundëso të pi nga burimi i Profetit Tënd Muhamed ﷺ një pije të këndshme pas së cilës nuk do të kem më etje kurrë. O Allah, kërkuj prej Teje çdo të mirë që e ka kërkuar Profeti Yt dhe kërkuj mbrojtje nga çdo e keqe prej së cilës ka kërkuar mbrojtje ai.

6. Gjatë rrotullimit të gjashtë:

اللَّهُمَّ إِنَّ لَكَ عَلَيَّ حُقُوفًا كَثِيرَةً فِيمَا بَيْنِي وَبَيْنَ خَلْقِكَ، اللَّهُمَّ مَا كَانَ لَكَ مِنْهَا فَاعْفِرْهُ لِي، وَمَا كَانَ لِخَلْقِكَ فَتَحَمَلْهُ عَنِّي، وَأَعْنِنِي بِحَلَالِكَ عَنْ حَرَامِكَ وَبِطَاعَتِكَ عَنْ مَعْصِيَتِكَ، وَبِفَضْلِكَ عَمَّنْ سِوَاكَ، يَا وَاسِعَ الْمَغْفِرَةِ

O Allah, nëse kam shumë detyrime ndaj Teje dhe ndaj krijesave të Tua, atë që është për Ty, fale, dhe atë që është për krijesat e Tua, mbaje

Ti për mua. Më pasuro me hallallin Tënd që të mos kem nevojë për haramin, me bindjen ndaj Teje që të largohem nga mosbindja dhe me mirësinë Tënde nga çdo tjetër përveç Teje, o i Gjëri në falje.

7. Gjatë rrotullimit të shtatë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ إِيْمَانًا كَامِلًا وَيَقِيْنًا صَادِقًا وَرِزْقًا وَاسِعًا وَقَلْبًا خَاشِعًا وَلِسَانًا ذَاكِرًا وَحَلَالًا طَيِّبًا وَتَوْبَةً نَّصُوْحًا قَبْلَ الْمَوْتِ وَمَعْفُوْرَةً وَرَحْمَةً بَعْدَ الْمَوْتِ وَالْعَفْوَ عِنْدَ الْحِسَابِ وَالْفَوْزَ بِالْجَنَّةِ وَالنَّجَاةَ مِنَ النَّارِ، بِرَحْمَتِكَ يَا عَزِيْزُ يَا عَفَّارُ

O Allah, kërkoh prej Teje besim të plotë, bindje të sinqertë, furnizim të gjerë, zemër të përlur, gjuhë që të përmend, hallall të pastër dhe pendim të sinqertë para vdekjes. Kërkoh falje dhe mëshirë pas vdekjes, lehtësim në ditën e llogarisë, fitimin e xhenetit dhe shpëtimin nga zjarri, me mëshirën Tënde, o i Fuqishëm, o Falës.

DUA MES RUKNIT JEMENI DHE GURIT TË ZI

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

Rabbenā ātinā fid-dunjā ḥaseneten, ve fil-
ākhirati ḥaseneten, ve ḳinā ‘adhāben-nār.

“O Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe të
mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i
zjarrit”

GABIME TË SHPESHTA NË TAVAF

- Tavafi pa abdes,
- Tavafi brenda mekemit Ismail,
- fërkimi i mureve të Qabes,
- shtyrja e njerëzve për Gurin e Zi,
- mendimi se çdo rrotullim ka dua të veçantë.

NAMAZI PAS TAVAFIT

Pas përfundimit të Tavafit, falen dy rekate namaz. Ky namaz është vaxhib. Preferohet të falet pas Mekami Ibrahimit. Nëse ka turmë, lejohet të falet kudo në Mesxhidul-Haram.

NIJETI I NAMAZIT TË TAVAFIT

نَوَيْتُ أَنْ أُصَلِّيَ لِلَّهِ تَعَالَى رُكْعَتَيْ طَوَافِ الْعُمْرَةِ مُسْتَقْبِلَ الْقِبْلَةِ،
اللَّهُ أَكْبَرُ

Nevejtu en uşallije li-llāhi te‘ālā rek‘atej ʔavāfi-l-‘umreti mustakʔbile-l-ķibleti, Allāhu ekber.

“Vendosa të fal për hir të Allahut të Lartësuar dy rekate namaz të tavafit të Umres, duke qenë i kthyer nga Kibla, Allahu Ekber”.

Nijeti bëhet **në zemër**, shqiptimi me gojë është i **lejuar**, por **jo obligim**.

Është e preferuar që:

- Në rekatin e parë të lexohet:
El-Fatiha dhe sureja El-Kafiruun.

- Në rekatin e dytë të lexohet:
El-Fatiha dhe sureja El-Ihlas.

UJI I ZEMZEMIT

Pas namazit, është sunet të pihet ujë nga Zemzemi. Është mirë që gota të miret me dorë të djathtë, të thuhet Bismil-lah, të kthehet ka Qabeja dhe të i lutet Zotit sipas dëshirës.

Dua gjatë pirjes së Zemzemit:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَرِزْقًا وَاسِعًا، وَشِفَاءً مِنْ كُلِّ دَاءٍ

Allāhumme innī as'aluke 'ilmen nāfi'an, ve rizқан vāsi'an, ve shifā'an min kulli dā'in.

“O Allah, unë të kërkoj dituri të dobishme, furnizim të bollshëm dhe shërim nga çdo sëmundje”.

SA'JI MES SAFASË DHE MERVES

Sa'ji është ecja mes Safasë dhe Merves shtatë herë. Që Sa'ji të jetë i vlefshëm, duhet:

- të bëhet pas Tavafit,
- të fillojë në Safa,
- të përfundojë në Merve,
- të kryhen 7 ecje të plota.

NIJETI I SA'JIT

اللَّهُمَّ إِنِّي أُرِيدُ السَّعْيَ بَيْنَ الصَّفَا وَالْمَرْوَةِ سَبْعَةَ أَشْوَاطٍ سَعْيِ
الْعُمْرَةِ فَيَسِّرْهُ لِي وَتَقَبَّلْهُ مِنِّي

Allāhumme innī urīdu s-sa'ja bejneş-Şafā vel-Merveti seb'ate ashvāṭin sa'ja-l-'umreti, fe jessirhu lī ve teqabbelhu minnī.

“O Allah, unë kam për qëllim të kryej Sa'jin ndërmjet Safasë dhe Merves, shtatë ecje Sa'j të Umres, ma lehtëso dhe ma prano prej meje”.

SAFĒ

Kur afrohet në Safa, lexohet ajeti:

إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ فَمَنْ حَجَّ الْبَيْتَ أَوْ اعْتَمَرَ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِ أَنْ يَطَّوَّفَ بِهِمَا وَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا فَإِنَّ اللَّهَ شَاكِرٌ عَلِيمٌ

Innaş-Şafā vel-Mervete min she‘ā’iri-llāh, fe-men ḥaxhxe-l-bejte evi‘temera fe-lā xhunāḥa ‘alejhi en jeṭṭavvefe bihimā, ve-men teṭavve‘a khajran fe-inna-llāhe shākirun ‘alīm.

“Me të vërtetë, Safa dhe Merve janë nga shenjat e Allahut. Prandaj, kush kryen Haxhin ose Umren në Shtëpinë e Shenjtë, nuk ka mëkat që të ecë ndërmjet tyre. E kush bën vepra të mira vullnetarisht, Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijsëm”.

Pastaj umrexhiu:

- kthehet nga Qabeja,
- ngrit duart,
- dhe lutet sipas dëshirës gjat gjithë ecjes mes Safas dhe Mervas.

dhe mbrëmje. Atij i bëjmë sexhde dhe vetëm Atë e adhurojmë, dhe Atë e madhërojmë gjatë natës së gjatë.

2. Gjatë ecjes së dytë:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ أَحَدٌ
صَمَدٌ لَمْ يَتَّخِذْ صَاحِبَةً وَلَا وَلَدًا وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمُلْكِ وَلَمْ
يَكُنْ لَهُ وَلِيٌّ مِنَ الذَّلِّ وَكَبَّرَهُ تَكْبِيرًا

Allahu është më i Madhi (tri herë). Falënderimi i takon Allahut. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Vetëm, Absolut. Ai nuk ka bashkëshorte e as fëmijë. Nuk ka shok në sundim dhe nuk ka nevojë për mbrojtës. Madhëroje Atë me madhërim të madh.

3. Gjatë ecjes së tretë:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبَّنَا أَنْتَ لَنَا نُورًا وَاعْفِرْ
لَنَا إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ
عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ وَأَسْتَغْفِرُكَ لِذُنُوبِي وَأَسْأَلُكَ رَحْمَتَكَ يَا أَرْحَمَ
الرَّاحِمِينَ

Allahu është më i Madhi (tri herë). Falënderimi i takon Allahut. Zoti ynë, plotësoje dritën tonë dhe na fal, sepse Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë. O Allah, kërkoj prej Teje çdo të mirë, të menjëhershme dhe të vonshme. Kërkoj falje për gjynahet e mia dhe kërkoj mëshirën Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

4. Gjate ecjes së katërt:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا تَعْلَمُ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا تَعْلَمُ وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا تَعْلَمُ إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ

Allahu është më i Madhi (tri herë). Falënderimi i takon Allahut. O Allah, kërkoj prej Teje të mirat që Ti i di, kërkoj mbrojtje nga të këqijat që Ti i di dhe kërkoj falje për gjithçka që Ti e di, sepse Ti je Njohësi i të fshehtave.

5. Gjatë ecjes së pestë:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ مَا شَكَرْنَاكَ حَقَّ شُكْرِكَ سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ مَا عِبَدْنَاكَ حَقَّ عِبَادَتِكَ اللَّهُمَّ

حَبِّبْ إِلَيْنَا الْإِيمَانَ وَزَيِّنْهُ فِي قُلُوبِنَا وَكَرِّهْ إِلَيْنَا الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ
وَالْعِصْيَانَ وَاجْعَلْنَا مِنَ الرَّاشِدِينَ

Allahu është më i Madhi (tri herë). Falënderimi i takon Allahut. I Pastër je Ti, o Allah, dhe Ty të takon falënderimi. Nuk të kemi falënderuar ashtu siç meriton falënderim. O Allah, na e bëj të dashur imanin dhe zbukuroje atë në zemrat tona. Na bëj që ta urrejmë kufirin, mëkatin dhe mosbindjen dhe na bëj prej të udhëzuarve.

6. Gjatë ecjes së gjashtë:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَى
وَالنَّقَى وَالْعِفَافَ وَالْغِنَى اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ كَمَا تَقُولُ وَخَيْرًا مِمَّا
تَقُولُ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ رِضَاكَ وَالْجَنَّةَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ سَخَطِكَ
وَالنَّارِ

Allahu është më i Madhi (tri herë). Falënderimi i takon Allahut. O Allah, kërkoj prej Teje udhëzim, devotshmëri, ndershmëri dhe pasuri shpirtërore. Falënderimi është Yti ashtu siç thua Ti dhe më mirë sesa themi ne.

Kërkoj kënaqësinë Tënde dhe Xhenetin dhe
kërkoj mbrojtje nga zemërimi Yt dhe zjarri.

7. Gjatë ecjes së shtatë:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ اللَّهُمَّ حَبِّبْ إِلَيْنَا الْإِيمَانَ
وَرَبِّتْهُ فِي قُلُوبِنَا وَكْرَهُ إِلَيْنَا الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ وَاجْعَلْنَا
مِنَ الرَّاشِدِينَ اللَّهُمَّ اخْتِمْ لَنَا بِالْخَيْرَاتِ وَحَقِّقْ لَنَا آمَالَنَا وَيَسِّرْ لَنَا
سُبُلَ رِضَاكَ يَا مُنْقِذَ الْعَرَقَى وَيَا مُنْجِيَ الْهَالِكِينَ

Allahu është më i Madhi (tri herë). Falënderimi i
takon Allahut. O Allah, na e bëj të dashur imanin
dhe zbukuroje në zemrat tona. Na bëj që ta
urrejmë kufirin, mëkatin dhe mosbindjen
dhe na bëj prej të udhëzuarve. O Allah, na
përfundo jetën me vepra të mira, realizo
shpresat tona dhe na lehtëso rrugët e
kënaqësisë Sate, o Shpëtues i të mbyturve dhe i
të shkatërruarve.

Pas përfundimit të sa'jit, preferohet kjo lutje:

رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا وَعَافِنَا وَاعْفُ عَنَّا وَعَلَى طَاعَتِكَ وَشُكْرِكَ أَعْنَا، وَعَلَى
غَيْرِكَ لَا تَكُنَّا، وَعَلَى الْإِسْلَامِ الْكَامِلِ تَوَفَّنَا وَأَنْتَ رَاضٍ عَنَّا

اللَّهُمَّ ارْحَمْنِي بِتَرْكِ الْمَعَاصِي أَبَدًا مَا أَبْقَيْتَنِي، وَارْحَمْنِي أَنْ
أَتَكَلَّفَ مَا لَا يُعِينُنِي، وَارْزُقْنِي حُسْنَ النَّظَرِ فِيمَا يُرْضِيكَ عَنِّي يَا
أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ

Zoti ynë, pranoji lutjet prej nesh. Na jep shëndet dhe na fal neve. Na ndihmo që të të nënshtrohemi dhe të të falënderojmë Ty. Mos lejo të mbështetemi tek ndokush tjetër pos Teje. Na mer shpirtin të bindur plotësisht në Islam dhe duke qenë i kënaqur me ne.

O Allah, më mëshiro t'i lë mëkatet sa të jem gjallë. Më mëshiro të mos merrem me diçka që nuk më intereson. Më furnizo me pamje të mirë në gjërat që të kënaqin Ty, o më mëshiruesi i gjithë mëshiruesve.

QETHJA OSE RRUATJA E FLOKËVE

Pas përfundimit të Sa'jit, umrexhiu kryen qethjen ose rruatjen e flokëve.

Për meshkuj:

- rruatja e plotë e kokës është më e preferuar,
- lejohet edhe shkurtimi i flokëve nga e gjithë koka.

Nuk mjafton vetëm prerja e disa qimeve të pakta.

Për gratë:

- shkurtojnë nga gërshetat sa maja e një gishtit (rreth 1–2 cm nga fundi i flokëve).

Pas qethjes ose rruatjes, umrexhiu del nga Ihrami dhe i lejohen të gjitha ato që ishin të ndaluara gjatë Ihramit.

DUATË DHE LUTJE SHITESË

Nuk ka dua-lutje të obligueshme për çdo rrotullim të Tavafit apo për çdo ecje të Sa'jit.

Umrexhiu mund të lutet me këto duatë ose me fjalët e veta, në gjuhën e vet.

AJETI I SAFASË DHE MERVES

إِنَّ الصَّفَاَ وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ فَمَنْ حَجَّ الْبَيْتَ أَوْ اعْتَمَرَ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِ أَنْ يَطَّوَّفَ بِهِمَا وَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا فَإِنَّ اللَّهَ شَاكِرٌ عَلِيمٌ

Innaş-Şafā vel-Mervete min she'ā'iri-llāh, fe-men ḥaxhxe-l-bejte evi'temera fe-lā xhunāḥa 'alejhi en jeṭṭavvefe bihimā, ve-men teṭavve'a khajran fe-inna-llāhe shākirun 'alīm.

“Me të vërtetë, Safa dhe Merve janë nga shenjat e Allahut. Prandaj, kush kryen Haxhin ose Umren në Shtëpinë e Shenjtë, nuk ka mëkat që të ecë ndërmjet tyre. E kush bën vepra të mira vullnetarisht, Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijsëm”.

DUAJA E KUNUTIT

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْتَعِينُكَ وَنَسْتَغْفِرُكَ وَنَسْتَهْدِيكَ وَنُؤْمِنُ بِكَ وَنَتُوبُ إِلَيْكَ
وَنَتَوَكَّلُ عَلَيْكَ وَنُثْنِي عَلَيْكَ الْخَيْرَ كُلَّهُ نَشْكُرُكَ وَلَا نَكْفُرُكَ وَنَخْلَعُ
وَنَتْرُكُ مَنْ يَفْجُرُكَ، اللَّهُمَّ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَلَكَ نُصَلِّي وَنَسْجُدُ وَإِلَيْكَ
نَسْعَى وَنَحْفِدُ نَرْجُو رَحْمَتَكَ وَنَخْشَى عَذَابَكَ إِنَّ عَذَابَكَ بِالْكَفَّارِ
مُلْحِقٌ

DUA PËR PRANIMIN E UMRES

اللَّهُمَّ تَقَبَّلْ مِنَّا هَذِهِ الْعُمْرَةَ وَاجْعَلْهَا عُمْرَةً مَقْبُولَةً وَسَعِيًّا
مَشْكُورًا وَذَنْبًا مَغْفُورًا

Allāhumme tekabbel minnā hādhihi-l-'umrah,
ve-xh'alhā 'umraten mekbūleten, ve sa'jen
meshkūren, ve dhanben maghfūren.

“O Allah, pranoje prej nesh këtë Umre, bëje atë
Umre të pranuar, Sa’j të shpërblyer dhe mëkat
të falur”.

DUA – LUTJE TË PREFERUARA GJATË GJITHË UMRES

اللَّهُمَّ تَقَبَّلْ مِنِّي عُمْرَتِي وَاجْعَلْهَا خَالِصَةً لِّوَجْهِكَ الْكَرِيمِ، اللَّهُمَّ
اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي كُلَّهَا دِقَّهَا وَجِلَّهَا، أَوْلَهَا وَآخِرَهَا، سِرَّهَا
وَعَلَانِيَتَهَا، اللَّهُمَّ طَهِّرْ قَلْبِي مِنَ النِّفَاقِ، وَعَمَلِي مِنَ الرِّيَاءِ،
وَلِسَانِي مِنَ الْكُذْبِ، يَا مُقَلِّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ، اللَّهُمَّ
إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَىٰ وَالْتِقَىٰ، وَالْعَفَافَ وَالْغِنَىٰ، اللَّهُمَّ أَجْرَنِي مِنَ
النَّارِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ، وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ،
اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي وَدُنْيَايَ وَأَهْلِي، وَاجْعَلْ الْخَيْرَ فِيمَا
أَعْطَيْتَنِي، اللَّهُمَّ لَا تَرُدَّنِي خَائِبًا، وَلَا تَحْرِمْنِي فَضْلَكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ
لِي وَلِوَالِدَيَّ وَارْحَمْهُمَا رَحْمَةً وَاسِعَةً، وَاجْزِهِمَا عَنَّا أَفْضَلَ
الْجَزَاءِ، وَمَكِّنَّا مِنْ بَرِّهِمَا وَالْإِحْسَانَ إِلَيْهِمَا، وَوَفِّقْنَا لِحِدْمَتِهِمَا
وَادْخَالَ السَّرُورِ عَلَى قُلُوبِهِمَا، كَمَا أَحْسَنَّا إِلَيْنَا وَرَبَّيْنَا صَغَارًا،
اللَّهُمَّ إِنْ كَانَا حَيِّينَ فَاطِلْ أَعْمَارَهُمَا عَلَى طَاعَتِكَ، وَإِنْ كَانَا
مَيِّتِينَ فَاجْعَلْ قُبُورَهُمَا رَوْضَةً مِنْ رِيَاضِ الْجَنَّةِ، وَاجْمَعْنَا بِهِمَا
فِي جَنَّاتِ النَّعِيمِ، بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ

O Allah, pranoje umren time dhe bëje të
singertë vetëm për kënaqësinë Tënde fisnike. O
Allah, m’i fal të gjitha mëkatet e mia: të vogla e
të mëdha, të hershme e të vonshme, të fshehta
e të hapura. O Allah, pastroje zemrën time nga
hipokrizia, veprat e mia nga syfaqësia dhe
gjuhën time nga gënjeshtria. O Ti që i kthen
zemrat, forcoje zemrën time në fenë Tënde. O

Allah, kërkuj prej Teje udhëzim dhe devotshmëri, pastërti dhe mjaftueshmëri. O Allah, më mbro nga zjarri. O Allah, kërkuj prej Teje xhenetin dhe çdo fjalë apo vepër që më afron drejt xhenetit. O Allah, përmirësoje fenë time, jetën time dhe familjen time dhe bëje të mirë atë që më ke dhënë. O Allah, mos më kthe i zhgënjyer dhe mos më privo nga mirësia Jote. O Allah, më fal mua dhe prindërit e mi dhe mëshiroji ata me mëshirë të gjerë. Shpërbleji ata për ne me shpërblimin më të mirë dhe na e mundëso që t'u bëjmë mirë, t'i respektojmë dhe t'u shërbejmë, dhe t'ua gëzojmë zemrat, ashtu siç u kujdesën ata për ne dhe na rritën kur ishim të vegjël. O Allah, nëse janë gjallë, jepu jetë të gjatë në bindjen ndaj Teje; e nëse kanë vdekur, bëji varret e tyre kopshte prej kopshteve të xhenetit dhe na bashko me ta në xhenetet e begata, me mëshirën Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

PËRFUNDIM

Ky doracak është përgatitur për t'i ndihmuar umrexhinjtë që Umren ta kryejnë me qetësi, dituri dhe sinqeritet, sipas medh-hebit Hanefi.

Lutemi që Allahu t'ua pranojë Umren të gjithë umrexhinjve, t'i falë mëkatet e tyre dhe t'i kthejë në vendet e tyre me zemra të pastruara. Allahu ua pranoftë Umren të gjithëve.

Amin.

